



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për transparencë në komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, nenit 61 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/18, në zbatim të Planit të Veprimit për transparencë për periudhën 2019 – 2023 në Komunën e Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 10 mars 2021, mori këtë,

VENDIM PËR VËNIEN NË DISKUTIM

Neni 1

Vëhet në diskutim publik:

- **Draft Rregullorja për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës**

(Draft në të cilin janë përfshirë dhe inkorporuar edhe propozimet e Ekzekutivit të Komunës / Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, sipas materialit përkatës me nr.prot. nr.01-300/01-0018458/21 të datës 25 shkurt 2021)

Neni 2

Diskutimi publik sipas nenit 1, zgjat 30 ditë përkatësisht prej **15 mars 2021 deri më 15 prill 2021**. Debat i publik me qytetarë dhe mbahet më **22 mars 2021** duke filluar nga **ora 10:00**, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhës - salla e mbledhjeve.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes të debatit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresat; nazmi.elezi@rks-gov.net dhe ejup.babatinca@rks-gov.net; të cilat pastaj përcjellën në Drejtorinë përkatëse, brenda periudhës së diskutimit publik.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve> (rubrika; aktet për diskutim publik)

Neni 5

Diskutimi/debati publik zbatohet nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, që përkujdeset për përgatitjen e raportit nga diskutimi / debati publik dhe të jap sqarime për arsyeshmërinë e pranimit ose mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6


Pas shqyrtimit dhe miratimit, Vendimi hyn në fuqi pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.01-300/01-0022481/21
Podujevë,
10 mars 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



D R A F T

**RREGULLORE
PËR ORARIN E PUNËS PËR BIZNESET
QË OPEROJNË NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS**

Podujevë, mars 2021

Në bazë të neneve 11, 12.1 dhe 12.2 shkronja c) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenin 40 të Ligjit nr.2004/18 për tregtinë e brendshme, Ligjin nr.04/L-005 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.2004/18 për tregtinë brendshme, nenet 14, 15 paragrafët 1 dhe 2.3, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 10 mars 2021, e vë në diskutim/debat publik, këtë;

DRAFT

RREGULLORE PËR ORARIN E PUNËS PËR BIZNESET QË OPEROJNË NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

Draft në të cilin janë përfshirë dhe inkorporuar edhe propozimet e Ekzekutivit të Komunës / Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, sipas materialit përkatës me nr.prot. nr.01-300/01-0018458/21 të datës 25 shkurt 2021 (nenet: 6, 15 dhe 20)

I. DISPOZITAT E PËRGGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës për Bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 2

Biznesit, në pajtim me nenin 1 të kësaj Rregulloreje, janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës të përcaktuar me këtë Rregullore.

Neni 3

1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore fillimin dhe mbarimin e punës.
2. Orari për fillimin dhe mbarimin e punës, i përcaktuar me këtë Rregullore, duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin kryhet veprimtaria e biznesit. Në orar të punës duhet cekur ditët kur nuk punohet.

II. Orari i punës

Neni 4

1. Orari i punës përcaktohet në bazë të llogaritjes verore dhe dimërore, në intervale kohore:

- 1.1. Periudha verore fillon më 1 prill dhe mbaron më 31 tetor të vitit;
- 1.2. Periudha dimërore fillon më 1 nëntor dhe mbaron më 31 mars të vitit

Neni 5

1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës për floktarët, rojtoret, sallonet e zbukurimit për meshkuj:

- 1.1. Periudha verore, prej orës 08:00 - 20:00
- 1.2. Periudha dimërore, prej orës 08:00 – 19:00
- 1.3. Ditën e diel dhe festave zyrtare nuk punohet.

Përrjashtim bënë nëse e diela apo festa zyrtare bie në natën e Vitit të Ri apo në natën e Bajramit.

2. Dyqanet e qepjes, këpuctarët, artarët, orëndreqësit dhe veprimtarit e përrefërta dyqanet punojnë:

- 2.1. Periudha verore, prej orës 08:00 – 20:00;
- 2.2. Periudha dimërore prej orës 08:00 - 19:00.

2.3. Ditën e diel dhe festave zyrtare nuk punohet. Përrjashtim bënë nëse e diela apo festa zyrtare bie në natën e Vitit të Ri apo në natën e Bajramit.

3. Sallonet e zbukurimit për femra:

- 3.1. Periudha verore prej orës 07:00 – 20:00;
- 3.2. Periudha dimërore prej orës 08:00 - 19:00;

3.3. Ditën e martë dhe gjatë festave zyrtare nuk punohet. Përrjashtim bënë periudha kohore nga 01.06 deri më 31.08(mund të punohet nga ora 05:00-20:00;) si dhe nëse dita e martë apo festa zyrtare bie natën e Vitit të Ri apo natën e Bajramit.

4. Auto serviset, serviset e mjeteve tjera dhe zejet e tjera të ngjashme:

- 4.1. Periudha verore, prej orës 08:00 – 20:00;
- 4.2. Periudha dimërore prej orës 08:00 – 19:00;

4.3. Në raste specifike mund të punohet më gjatë me kusht që lokali duhet të jetë i mbyllur.

4.4. Ditën e diel dhe festave zyrtare nuk punohet. Përrjashtim bënë nëse e diela apo festa zyrtare bie në natën e Vitit të Ri apo në natën e Bajramit.

5. Auto-larjet, larja e orendive shtëpiake, larja e lokaleve dhe zyreve dhe veprimtaritë e tjera të përrefërta:

- 5.1. Periudha verore, prej orës 08:00- 20:00;
- 5.2. Periudha dimërore, prej orës 08:00 – 19:00;
- 5.3. Nuk punohet gjatë festave zyrtare.

Neni 6

1. Orari i punës në Qendrat tregtare dhe supermarketet, do të jetë:
 - 1.1. Periudha verore prej orës 07:00 - 23:00
 - 1.2. Periudha dimërore prej orës 07:00 - 22:00
2. Orari i punës në marketet dhe dyqanet e vogla ushqimore, do të jetë:
 - 2.1. Periudha verore prej orës 07:00 - 23:00
 - 2.2. Periudha dimërore prej orës 07:00 - 22:00
3. Orari i punës në dyqanet tregtare të tekstilit, dyqanet e këpucëve, dyqanet e pajisjeve teknike shtëpiake, teknikës së bardhë, bizhuterive dhe veprimtarive të tjera jo ushqimore me pakicë do të jetë:
 - 3.1. Periudha verore prej orës 07:00 - 22:00
 - 3.2. Periudha dimërore prej orës 07:00 - 22:00
4. Orari i punës për dyqanet e pajisjeve sanitare të rrymës, ujit dhe të ngjashme do të jetë:
 - 4.1. Periudha verore prej orës 07:00 - 22:00
 - 4.2. Periudha dimërore prej orës 07:00 - 22:00
5. Orari i punës për barnatoret bujqësore, dyqanet e pemëve dhe perimeve do të jetë:
 - 5.1. Periudha verore prej orës 07:00 - 22:00
 - 5.2. Periudha dimërore prej orës 07:00 - 22:00
6. Bizneset e përfshira në këtë nen nuk punojnë ditën e diel dhe festave zyrtare, përjashtim bëjnë bizneset nga paragrafi 2, paragrafi 4 dhe paragrafi 5 që mund të punojnë ditën e diel prej orës 08:00 - 13:00.
 - 6.1. Bizneset nga paragrafi 2 mund të parashirojnë kërkesë në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik për lejin e vazhimit të punës ditën e diel edhe pas orës 13:00.
Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, bazuar në arsyeshmërinë e kërkesës, lëshon Pëlqimin me shkrim për lejin e punës pas orës 13:00, ditën e diel, Pëlqim i cili lëshohet pa pagesë.
7. Në rast se nata e vitit të ri ose nata e Bajramit bie ditën e diel ose në festë zyrtare, bizneset nga paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni mund të punojnë sipas orarit të rregullt të përcaktuar për periudhën kohore.

Neni 7

1. Orari i punës në depot e artikuljeve ushqimorë, depot e materialit ndërtimor dhe në ndërmarrjet që merren me prodhimin e betonit, do të jetë:
 - 1.1. Periudha verore, prej orës 08:00 - 19:00;
 - 1.2. Periudha dimërore, prej orës 08:00 – 18.00
2. Ditën e fundjavës (të dielën) dhe gjatë ditëve të festave, depot nuk punojnë.
3. Orari i punës në bizneset ndërtimore (ndërtimi i ulët dhe i lartë), do të jetë:
 - 3.1. Periudha verore, prej orës 07:00 - 18:00.
 - 3.2. Periudha dimërore, prej orës 08:00 - 17:00.
4. Bizneset ndërtimore, në raste të jashtëzakonshme, për shkak të natyrës së punëve dhe për hirë të interesit publik, me leje të posaçme, të cilën e lëshon Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, mund të punojnë me orar të zgjatur deri në orën 23:00.

Neni 8

1. Orari i punës i bizneseve hoteliere si restaurantet, kafet, baret, shisha-baret ëmbëltoret-pastiqerit: do të jetë:
 - 1.1. Periudha verore, prej orës 07:00-24:00
 - 1.2. Periudha dimërore, prej orës 07:00 – 23:00.
2. Orari i punës në hotele, motele është i njëjtë në të dy sezonet dhe fillon prej orës: 00:00 - 24:00
Pas orës 24.00 nuk lejohet shërbimi për mysafirë jashtë objektit.
3. Orari i punës për internet –kafë, video lojra dhe të tjera të ngjajshme:
 - 3.1 Periudha verore, prej orë 08:00-24:00
 - 3.2 Periudha dimërore, prej orës 08:00-23:00
4. Orari i punës për bizneset e ushqimit të shpejt (fast food), picerive, burektoreve dhe të tjera të ngjashme:
 - 4.1 Periudha verore, prej orës 07:00-24:00
 - 4.2 Periudha dimërore, prej orës 07,00-23:00

Neni 9

1. Orari i punës për gjelltoret;

1.1. Periudha verore prej orës 07:00-21:00

1.2. Periudha dimërore, prej orës 07:00-20:00.

1.3. Ditën e Diel dhe festave zyrtare nuk punojnë, përjashtim bëjnë rastet e dërgesave për ahengje apo raste mortore, por kusht është se objekti duhet të jetë i mbyllur për konsumatorët-klientët individual.

Neni 10

Stadiumet e improvizuara të futbollit dhe palestrat sportive, fitneset, punojnë prej orës 08:00-24.00.

Neni 11

1. Veprimtarive të parapara në nenet 8, 9 dhe 10 të kësaj Rregulloreje gjatë orarit të punës, nuk iu lejohej t'u prishin qetësinë qytetarëve që banojnë në afërsi të lokaleve ku ushtrohet veprimtaria.

2. Bizneset janë të obliguara të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në pajtim me Ligjin për Rendin dhe Qetësinë Publike, si dhe Ligjin për Mbrojtje nga Zhurma.

Neni 12

1. Orari i punës për tregjet e qytetit dhe tregjet e lokaliteteve është:

1.1. Periudha verore, prej orës 06:00 – 19:00.

1.2. Periudha dimërore, prej orës 07:00 – 18:00.

2. Tregu i gjelbër nuk do të punojë gjatë ditës së fundjavës (të dielën) dhe ditëve të festave.

3. Tregu i kafshëve punon të shtunave.

Neni 13

Në objektet hoteliere, të cilat gjenden në afërsi deri në 100 m nga objektet e banimit, në të cilat organizohet program me muzikë të gjallë apo me audio - video mjete për reproduktimin e programit, programi nuk mund të vazhdojë pas orës 24:00.

Neni 14

Orari i punës në pikat e shitjes së karburanteve është i njëjtë në të dy sezonet, fillon prej orës 00:00 dhe zgjatë deri në orën 24:00 (pa ndërprerë).

Neni 15

1. Barnatoret :

- 1.1. Periudha verore prej orës 08:00 – 22:00;
- 1.2. Periudha dimërore prej orës 08:00 – 22:00
- 1.3. Barnatoret ndahen në tre zona, Zona I – barnatoret që gjinden në afërsi të spitalit të qytetit, Zona II – barnatoret që gjinden mbrenda qytetit si dhe Zona III – barnatoret të cilat operojnë nëpër fshatrat e komunës.
- 1.4. Orari i kujdestarisë të dielave dhe ditëve zyrtare është nga ora 08:00-22:00 (Kujdestarohet nga një barnatore për secilen Zonë I, II dhe III.)
- 1.5. Orari i kujdestarisë së natës prej orës 22:00-08:00 |(Kujdestarohet nga një barnatore në zonën I si dhe zonën II.)
- 1.6. Orari i kujdestarive do të përgatitet nga Barnatoret së bashku, i cili do të silltet në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, për miratim.

2. Ordinancat private mjekësore

- 2.1. Klinikat Specialistike prej orës 08:00 – 20:00;
- 2.2. Ordinancat Stomatologjike prej orës 10:00 – 20:00;
- 2.3. Laboratorët dhe Rentgenët prej orës 07:00 – 19:00;

3. Ordinancat veterinarë

- 3.1. Periudha verore prej orës 07:00 - 24:00
- 3.2. Periudha dimërore prej orës 08:00 - 24:00
- 3.3. Në raste të nevojave emergjente lejohet puna më gjatë se paragrafi 3.1 dhe 3.2.

4. Të dielave dhe festave zyrtare (1 janar, 17 shkurt, dita e Fitër Bajramit dhe dita e Kurban Bajramit) është ditë pushimi, përjashtim bëjnë bizneset nga paragrafi 1 që bëjnë kujdestari si dhe bizneset nga paragrafi 3, që mund të punojnë sipas nevojave për arsye të punës specifike.

Neni 16

1. Furrat e bukës

- 1.1. Periudha verore prej orës 06:00 – 00:00;
- 1.2. Periudha dimërore prej orës 06:00 – 00:00;
- 1.3. Gjatë muajit të Ramazanit do të punohet deri në syfyr.

2. Mishtoret

- 2.1. Periudha verore prej orës 07:00 – 20:00;
- 2.2. Periudha dimërore prej orës 07:00 – 20:00;
- 2.3. Ditëve të Diela dhe festave zyrtare nuk punohet.
- 2.4. Përjashtim nga pika 2.3. e këtij neni bëjnë rastet kur kanë porosi sasiore për bizneset hoteliere me kusht që lokali duhet të jetë i mbyllur për konsumatorët tjerë.

Neni 17

1. Bizneset që ofrojnë shërbime të telefonisë, IT-së, mjeksore, arsimore dhe ato financiare punojnë :

1.1. Periudha verore: 07:00-22.00

1.2. Periudha dimërore: 07:00-21.00

2. Të dielave dhe festave zyrtare e kanë ditë pushimi.

Neni 18

1. Zgjatja e orarit të punës.

1.1. Bizneset që dëshirojnë të punojnë më shumë se orari i përcaktuar me këtë rregullore, mund të parashirojnë kërkesë në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik e cila pas shqyrtimit, mund të lëshoj leje të posaçme për zgjatje të orarit, por jo më shumë se deri në ora 03:00. Për çdo orë shtesë duhet të paguhet taksë prej 50,00 euro. Meqenëse kjo mundësi u jepet bizneseve që për çfarëdo llojë nevojë apo situatë të punojnë më gjatë, biznesi duhet të ofroj dëshmi bindëse për orarin shtesë dhe këtë mund ta shfrytëzojnë deri në 3(tre) herë gjatë vitit.

1.2. Bizneset hoteliere me rastin e festave zyrtare mund të zgjatin orarin e punës për 1 (një) orë, dhe nuk do të paguajnë taks shtesë.

Neni 19

1. Bizneset prodhuese dhe ato përpunuese mund të punojnë sipas vëllimit dhe nevojave të tyre por duke respektuar standardet, sigurinë dhe qetësinë publike.

2. Bizneset që nuk janë të përfshira në dispozitat e kësaj Rregulloreje e propozojnë orarin e punës të cilin në formë të shkruar me pëlqim e aprovon Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

Neni 20

Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik mundet me vendim të posaçëm, kur e kërkon interesi publik të lejojë punën e bizneseve edhe në ditë pushimi apo feste.

III. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 21

Bizneset do të gjobiten për kundërvajtje, në qoftë se veprojnë në kundërshtim me nenet 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12,13,14,15,16,17,18 dhe 19 të kësaj Rregulloreje, si më poshtë:

1.1. Personat juridik200 – 400 €

1.2. Personat fizik100 – 200 €

IV. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 22

Zbatimin e kësaj Rregulloreje e bënë Drejtoria e Inspekcionit dhe Drejtoritë tjera përkatëse të Komunës në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Gjykatën Kompetente.

Neni 23

Të gjitha bizneset janë të obliguara që të harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e kësaj Rregulloreje, në afatin tridhjetë (30) ditësh nga dita e hyrjes së kësaj Rregulloreje në fuqi.

Neni 24

Me hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja dispozitat e mëparshme komunale të cilat kanë rregulluar këtë lëmi.

Neni 25

Pas shqyrtimit dhe miratimit final nga ana e Kuvendit, Rregullorja hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 parag. 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

**Podujevë,
10 mars 2021**

**Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi**

